

Raporti i Rregullt Ekonomik – Dokument për sektorin financiar: pikat e dobëta, mundësitë e zbutjes së pasojave dhe opsionet për politikat¹

- *Sektori financiar mund të bëjë shumë për ndihmuar në zbutjen e pasojave të COVID-19 në ekonominë reale duke siguruar financim kalimtar dhe ristrukturim të kredive për firmat rentabël për t'i ndihmuar këto të fundit në përballimin e pasojave të krizës, në përshtatjen ndaj mjedisit të ri ku ushtrojnë aktivitetet dhe në dhënien e një kontributi për fazën e rimëkëmbjes.*
- *Cenueshmëritë e reja në sektorin financiar kanë më shumë ndikim në tregjet e reja si Ballkani Perëndimor, sistemet financiare të të cilat janë më pak të përgatitur për t'u ballë goditjeve.*
- *Megjithëse sektorët financiarë kombëtarë të rajonit në përgjithësi gëzojnë stabilitet, është e nevojshme të ndiqen nga afër zhvillimet e kreditimit dhe likuiditetit duke qenë se COVID-19 përbën rrezikun më të madh në botë e në vend që pas vitit 2008.*
- *Stresi i zgjatur financiar do të sjellë nevojën për marrjen e masave për parandalimin e akumulimit të risqeve të stabilitetit financiar.*

1. Përshkallëzimi i epidemisë COVID-19 përbën një krizë, si për anën e ofertës, ashtu edhe për atë të kërkesës, shkalla, kohëzgjatja dhe pasojat financiare, buxhetore dhe shoqërore të së cilës nuk janë ende të qarta. Përhapja e vrullshme e këtij virusi në mbarë botën ka arritur përmasat e pandemisë dhe ka nxitur marrjen e një sërë masash të jashtëzakonshme: ulje të normave, mbështetje me likuiditet, shtyrje në kohë të tatim-taksave, ndalim të udhëtimeve, mbyllje të detyrueshme të bizneseve, kufizime mbi tubimet; me qëllim kufizimin e përhapjes, zbutjen e pasojave mbi veprimtarinë ekonomike dhe shmangien e çrregullimit të tregjeve financiare. Megjithëse në rajon ka filluar lehtësimi gradual i masave të bllokimit, familjet dhe bizneset, sidomos ndërmarrjet shumë të vogla, të vogla dhe të mesme (NMVM), gjenden përballë rënies së të ardhurave, ndërprerjeve të zinxhirëve të furnizimit, kushteve më të forta kreditore dhe përballë një krize likuiditeti; të gjitha së bashku, këto sjellin vonesa në livrime të mallrave dhe në pagesa dhe shkaktojnë humbje të vendeve të punës dhe, si përfundim, mbyllje dhe falimentim të bizneseve. Ulja e rentabilitetit, rënia e cilësisë së aktiveve dhe ngadalësimi i rritjes së kreditimit mund të kenë pasojat të një raundi të dytë në ekonominë reale dhe mund të vënë në rrezik stabilitetin financiar.

¹ Ky dokument është përgatitur nga Ruvejda Aliefendic, Gunhild Berg, Keler Gjika, Johanna Jaeger, Alena Kantarovich, Alper Ahmet Oguz, Blerta Qerimi dhe Nan Zhou. Dokumenti ka përfituar nga komentet e bëra nga Mario Guadamillas, Miquel Dijkman, Marc Tobias Schiffbauer, Edith Kikoni dhe Enrique Blanco Armas.

Pengesat e shkaktuara nga mungesa e personelit në institucionet financiare dhe në entet rregullatore mund të cenojnë ofrimin e shërbimeve financiare. Rritja e pasigurive dhe mungesa e dëshirës për të marrë risqe mund ta rritin koston e financimit në tregjet e brendshme dhe të jashtme të kapitalit.

A. Panoramë e sektorëve financiarë të Ballkanit Perëndimor sot


2. Megjithëse sektorët financiarë kombëtarë të rajonit në përgjithësi gëzojnë stabilitet, është e nevojshme të ndiqen nga afër zhvillimet e kreditimit dhe likuiditetit duke qenë se COVID-19 përbën rrezikun më të madh në botë e në vend që pas vitit 2008. Ndërkohë që këto vende i japin përgjigje ndikimit të plotë të pandemisë, ato kanë avantazhin që treguesit e sistemeve financiare i kanë në përgjithësi solidë. Në tërësi, bankat kanë kapital të mjaftueshëm dhe janë rentabël dhe treguesit janë përmirësuar me kalimin e kohës. Në 2019, mjaftueshmëria e kapitalit në banka qe mesatarisht 18,3 për qind, shumë më lart se minimumi rregullator. Në krahasim me 1,7 për qind një vit më parë, rentabiliteti i matur si raporti i kthimit mbi aktivet ka rënë paksa në 1,6 për qind, por raporti i aktiveve likuide mbi aktivet gjithsej mesatarisht është 29 për qind dhe raporti kredi/depozita është nën 100 në çdo rast (shih Tabelën 1 për treguesit dhe tendencat). De-euroizimi ka qenë i ngadaltë por konstant, megjithëse stoku i kredive të pashlyera në valutë të huaj shkon nga 41 për qind të kredive gjithsej në Maqedoninë e Veriut në thujse 70 për qind në Serbi. Ka edhe një risk të konsiderueshëm të tërthortë të kredisë për shkak të ekspozimit ndaj huamarrësve të pambuluar me instrumente mbrojtëse në rast të rënies së vlerës së valutës. Bankat, të cilat mbizotërojnë në sistemet financiare të rajonit, në përgjithësi ndjekin modele më tradicionale biznesi, kryesisht duke u financuar me depozita nga vendasit, në dallim nga homologët e tyre në BE, ndërsa ndërmjetësimi financiar mbetet në nivele të ulëta. Në të njëjtën kohë, Ballkani Perëndimor përbëhet nga ekonomi të vogla e të hapura, me sektorë bankarë ku mbizotëron kapitali i huaj, çka i bën të cenueshme nga krizat e jashtme.

3. Rritja e kreditimit ishte pozitive deri në fund të vitit 2019, ku huadhënia për klientët familje kishte rritje më të shpejtë se për klientët biznes, çka kërkon një monitorim nga afër. Në veçanti, huadhënia për klientët familje është zgjeruar vazhdimisht në të gjitha vendet e rajonit, me mbështetjen e normave të ulëta rekord të interesit, kushteve të qëndrueshme të kredive bankare dhe besimit të fortë të konsumatorëve. Deri në fund të vitit 2019, totali i kredive të pashlyera për familjet në rajon është rritur mesatarisht 9 për qind (6 për qind për bizneset). Me këtë rritje të lartë të kreditimit për familjet dhe me afatet e gjata të shlyerjes për kreditë konsumatore në disa vende, u duhet kushtuar vëmendje e veçantë

risqeve dhe cenueshmërive. Kosova ka pasur sërish rritjen më të fortë të kreditimit të sektorit privat, në diçka më shumë se 10 për qind në dhjetor 2019 (matje vjetore), me lehtësimin e standardeve të kredive dhe me mbështetjen e një kërkesë të fortë; pas saj vjen Serbia me një rritje të kredive në sektorin privat mbi 8 për qind për shkak të rritjes së shëndetshme të kërkesës bazuar në standarde kredie përgjithësisht neutrale. Huadhënia në Bosnjë dhe Hercegovinë (BH) dhe në Malin e Zi qe 6-7 për qind. Në Shqipëri, me përmirësimin gradual të kërkesës, rritja e kreditimit po përshejton, duke arritur 6 për qind në vitin 2019.² Rritja e kreditimit në Maqedoninë e Veriut është ngadalësuar në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2019, me rënien e huadhënies për bizneset, nën ndikimin e shuarjes nga bilanci të kredive nën standard; nga 8 për qind që ishte në fillim të vitit 2019, u ngadalësua në diçka më shumë se 6 për qind në fund të vitit (Figura 1). Pavarësisht nga progresi i përgjithshëm në thellimin e tregjeve të kredisë në të gjithë Ballkanin Perëndimor, kreditimi vendas për sektorin privat vijon të mbetet ndjeshëm mbrapa niveleve të BE-së.

Figura 1. Teprica e principalit të pashlyer të kredive ka vijuar të rritet në mbarë rajonin.

(Ndryshimi i kreditimit të sektorit privat jofinanciar, %, normë vjetore)




Burimi: SFN të FMN-së, bankat qendrore.

Shënim: Të dhënat e njëtrajtshme për rritjen e kreditimit për sektorin privat në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe në Serbi janë nga Statistikat Financiare Ndërkombëtare (SFN) të FMN-së. Të dhënat për kreditimin e familjeve dhe të shoqërive tregtare janë nga bankat qendrore kombëtare. Shoqëri të tjera të anketuara janë shprehur në monedhën vendase (euro, në rastin e Kosovës). Të dhënat për Malin e Zi bazohen në statistikat e bankës qendrore për kreditimin për rezidentët por jo për qeveritë dhe institucionet financiare.

Figura 2. Kreditimi për familjet është rritur vazhdimisht, por jo kreditimi për firmat.

(Ndryshimi i kreditimit, %, normë vjetore)



Burimi: Bankat qendrore.

² Anketa e Huadhënies Bankare në EQEJL për gjashtëmuorin II të vitit 2019.

4. **Niveli i kredive nën standard ka rënë në të gjitha vendet por zbehja e perspektivave ekonomike pritet të ndikojë negativisht te cilësia e aktiveve dhe t'i frenojë bankat nga huadhënia.** Gjatë të gjithë vitit 2019, niveli mesatar rajonal i kredive nën standard ra përsëri, në 5,3 për qind të kredive gjithsej, duke iu afruar nivelit ku ndodhej përpara krizës financiare botërore prej rreth 4,4 për qind. Niveli i kredive nën standard në Kosovë është më i ulëti në rajon por megjithëse me trend rënës, kreditë nën standard janë ende të larta në Shqipëri (8,4 për qind) dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë (7,7 për qind) (Figura 2). Reformat e kohëve të fundit kanë ndihmuar për një ulje të konsiderueshme të kredive nën standard, ndërkohë që Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia vijojnë të shuajnë nga bilancet e të shesin kredi të vjetra nën standard. Në Shqipëri, në entitetin Republika Srpska të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe në Kosovë ka ligje të reja për falimentimin. Në korrik të vitit 2019, Banka e Shqipërisë miratoi një kornizë për ristrukturimin vullnetar jashtëgjyqësor të kredive të mëdha nën standard. Mali i Zi e ka zgjeruar mbulimin e regjistrimit të kredive për të rritur kapacitetin e huadhënies për vlerësimin e riskut të kredisë dhe e ka harmonizuar rregulloren e menaxhimit të riskut të kredisë me standardet e Autoritetit Bankar Europian. Por ka të dhëna se në shumë vende, pavarësisht nga përmirësimet e vëna re në nivelin e raportuar të kredive nën standard, vijon të jetë problematik pozicioni financiar i huamarrësve nga sektori privat. Do të jetë edhe më e rëndësishme të përforcohen regjimet e falimentimit të shoqërive tregtare dhe të konsumatorëve për t'u dhënë zgjidhje rasteve të mospagimit të kredive.

Tabela 1: Bankat kanë kapital të mjaftueshëm, janë likuide dhe rentabël me tregues të përmirësuar me kalimin e kohës (%).

Ekonomia	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	Aktive likuide mbi aktive totale	Raporti kredi/depozita	Kthimet mbi aktivet	Kthimi mbi kapitalin neto	Raporti i kredive nën standard
Shqipëria	↑ 18.3	35.7	54.0	1.5	13.4	↓ 8.4
Bosnja dhe Hercegovina	↑ 18.1	29.6	88.7	1.4	11.1	7.4
Kosova	15.9	28.9	77.6	2.1	18.4	2.0
Mali i Zi	↑ 17.7	↓ 20.8	88.1	↑ 1.3	↑ 10.0	5.1
Maqedonia e Veriut	↑ 16.3	24.0	↓ 83.8	1.3	13.5	4.6
Serbia	23.4	36	91.6	1.8	10.5	4.1

Shënim: Statistikat, në përqindje, bazohen në informacionet e marra më 15 prill 2020. Këto pasqyrojnë gjendjen e sistemeve financiare në fund të muajit dhjetor 2019. Aktive likuide mbi aktive gjithsej për Shqipërinë nënkuptojnë vlerën e përgjithshme të

publikuar nga Banka e Shqipërisë. Shigjetat majtas vlerave tregojnë ndryshimet përtej një devijimi standard historik nga mesataret e tre viteve më të fundit. Ikonat djathtas ilustronë zhvillimin e treguesit gjatë një dekade.

B. Cenueshmëritë e sektorit financiar

5. **Sistemet financiare preken nëpërmjet katër kanaleve kryesore:** Ndikimi i krizës në sektorin financiar varet nga aftësia e këtij sektori për të zbutur katër risqe: a) *Risku i tregut:* Luhajtjet akute të ndjeshmërisë së investitorëve, e ndërthurur me pasiguritë e rritura, mund ta rritin koston e financimit, si në tregjet e huaja, ashtu edhe në ato vendase, për qeverinë dhe për sektorin privat. b) *Risku i likuiditetit:* Paqëndrueshmëria e tregjeve që tani e ka rritur kërkesën për likuiditet. Për më tepër, problemet me flukset monetare të firmave të prekura dhe ndryshimi i kërkesës publike për mjete monetare mund t'i shtrëngonte kushtet e financimit dhe likuiditetit për bankat, duke cenuar kështu, si përfundim, huadhënien për sektorin privat. Rritja e kërkesës për instrumente në valutë të huaj mund të shkaktonte një krizë të vërtetë likuiditeti. c) *Risku i kredisë:* Zbehja e perspektivave ekonomike do ta rritë nivelin e kredive nën standard dhe do t'i frenojë institucionet bankë dhe jo-bankë nga huadhënia për mbështetjen e veprimtarisë reale. Risqet e kredisë ndërlikohen më tej kur firmat dhe familjet me likuiditet të pakësuar kanë borxhe për të shlyer por nuk arrijnë të gjejnë financim kalimtar për të mbuluar humbjen e të ardhurave. d) *Risku ndaj fitimeve dhe qëndrueshmërisë.* Risqet e mëparshme do t'i dobësojnë fitimet dhe rentabilitetin në sektorin financiar, sidomos nëse vijojnë më tej kushtet e tanishme.

6. **Këto risqe kanë më shumë ndikim në tregjet e reja si Ballkani Perëndimor sistemet financiare të të cilit janë më pak të përgatitura për t'u bërë ballë goditjeve.** Qeveritë duhet t'u bëjnë ballë tregjeve të luhatshme të financimit, ndërkohë që shohin rritje në nevojat për financim dhe në kostot e financimit, flukse dalëse të kapitalit të huaj dhe rritje të paparashikueshmërisë së sjelljes së investitorëve. Në mars flukset dalëse të portofolit nga ekonomitë e reja të Europës qenë rreth 4,8 miliardë US\$, nga të cilat 3,3 miliardë US\$ kapital neto dhe 1,4 miliardë US\$ flukse dalëse borxhi.³ Pandemia COVID-19 ka nxitur edhe humbje të rënda në tregjet e kapitalit, me rënie prej 10 për qind të vlerës së aksioneve europiane dhe me 25 për qind rënie të indeksit S&P 500 që në fillim të muajit shkurt.⁴ Po kështu, në rajon BELEX15 (Serbi) ka humbur rreth 15 për qind të vlerës pas kulmit në muajin shkurt dhe MBI10 (Maqedonia e Veriut) ka humbur rreth 20 për qind. Lidhjet financiare, sidomos me BE-në, kanë fituar rëndësi si pasojë e integritimit

³ Instituti i Financave Ndërkombëtare: Gjurmuesi i Flukseve të Kapitalit, prill 2020.

⁴ Banka Botërore. 2020. "Lufta kundër COVID-19, përditësim ekonomik për Europën dhe Azinë Qendrore (pranverë)." Uashington, D.K: Banka Botërore.

të tregjeve financiare të Ballkanit Perëndimor, ndërsa ekspozimi ndërkufitar i institucioneve financiare po i bën vendet të cenueshme ndaj efekteve domino nga anë të tjera të rajonit. Ky rajon mbështetet gjithashtu shumë në flukset hyrëse të dërgesave private nga jashtë (thujse 10 për qind të PBB-së në vitin 2018), të cilat kanë pësuar një goditje të rëndë nga kriza. Niveli i lartë i përdorimit jo zyrtarisht të euros përbën një risk për stabilitetin financiar të vendeve ku bankat rrezikohen nga risku i tërthortë i kredisë për shkak të ekspozimit ndaj huamarrësve të pambuluar me instrumente mbrojtëse dhe për shkak të rritjes së kërkesës për instrumente në valutë të huaj. Megjithëse niveli i kredive nën standard ka rënë në mbarë rajonin, ky nivel vijon të jetë i lartë në Shqipëri dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ndikimi që kanë perspektivat e paqarta ekonomike mbi cilësinë e aktiveve dhe mbi gatishmërinë e bankave për të dhënë kredi mund të çojë në rreth vicioz të ecurisë nën standard të sektorit financiar dhe rënie të rritjes ekonomike.

7. **Risqe të mëtejshme lindin nga kufizimet monetare dhe menaxhimi i krizës dhe nga cenueshmëritë e borxhit të sektorit privat.** Sa i takon parandalimit të krizës, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi kanë shumë pak kontroll mbi politikën e tyre monetare, çka ua vështirëson menaxhimin dhe mbështetjen me likuiditet. Megjithëse gjatë dekadës së fundit ka pasur përmirësime të konsiderueshme, në mbarë rajonin ka ende pika të dobëta në kornizat ekzistuese për menaxhimin e krizave, mbikëqyrjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Gjithashtu, kanë lindur cenueshmëri të sektorit privat nga ndërthurje e faktorëve të tillë si niveli i borxhit të sektorit të biznesit dhe të sektorit të familjeve dhe monedha dhe struktura e amortizimit të borxhit. Në veçanti, shqetësim përbën shëndeti financiar i shoqërive tregtare duke qenë se ende ka pa zgjidhur borxhe nga kriza e vitit 2008-2009.

C. Zbutja e cenueshmërive të sektorit financiar dhe mbështetja me likuiditet për bizneset

8. **Sektori financiar mund të bëjë shumë për të ndihmuar në zbutjen e efektit që ka në ekonominë reale COVID-19.** Financimi kalimtar nga bankat dhe ristrukturimi i kredive për huamarrësit solidë të cilët kanë hasur në mungesë të mjeteve monetare mund t'i ndihmojë këta të zbusin pasojat e krizës, t'i përshtaten mjedisit të ri ku ushtrojnë aktivitetet dhe, në fund, të kontribuojnë në fazën e rimëkëmbjes. Këtu, linjat e kreditimit dhe dorëzimit të pjesshme të kredive⁵ mund të sigurojnë financim shtesë për t'i mbajtur në punë ndërmarrjet rentabël dhe për të rimëkëmbur flukset kreditore për forcimin e

⁵ Shih, për më shumë informacion, "Parimet për skemat publike të dorëzimit të kredive për NVM-të": <http://documents.worldbank.org/curated/en/576961468197998372/pdf/101769-REVISED-ENGLISH-Principles-CGS-for-SMEs.pdf>.

investimeve. Gjatë fazës së rimëkëmbjes, eksportuesit dhe firmat e integruara në zinxhirët e furnizimit do të përfitonin edhe nga financimi i përshtatur për eksportet, blerja e borxheve dhe mekanizmat e sigurimit të kredisë. Masat e sektorit financiar për mbështetjen e ekonomisë duhet të jenë të gjera, transparente dhe të shpejta, duke ruajtur drejtpeshimin me shqetësimet për stabilitetin financiar. Masat urgjente duhet të jenë me afate të caktuara dhe të kenë strategji të qarta të daljes nga situata.

9. **Masat e kujdesshme mund të krijojnë me përgjegjshmëri hapësirë kapitali për rifillimin e huadhënies nga bankat.** Kjo mund të bëhet nëpërmjet çlirimit të amortizatorëve kundërciklikë të kapitalit, çlirimit të amortizatorëve konservatorë dhe ndalimit të përkohshëm të shpërblimeve shtesë për drejtuesit, ndarjes së dividendëve dhe riblerjes së aksioneve. Vendet mund të miratojnë edhe të lejojnë bankat të ushtrojnë aktivitet në nivelet e mjaftueshmërisë së kapitalit, si për shembull duke miratuar moratoriume të përkohshëm e të përcaktuar qartë mbi shlyerjen e kredive. Masa të tjera, në veçanti pezullimi i klasifikimit dhe provigjionimit të kredive, mund të krijojnë me shpejtësi risqe serioze për bankat dhe për klientët, për të mos përmendur vështirësimin e kundërpërgjigjeve të enteve mbikëqyrëse nëse nuk janë të përkohshme e të monitoruara nga afër. Prandaj, këto lloj masash duhen vlerësuar rast pas rasti.⁶

10. **Në të njëjtën kohë, stresi i zgjatur financiar do të ketë nevojë për marrjen e masave për parandalimin e akumulimit të risqeve të stabilitetit financiar.** Bankat qendrore dhe autoritetet mbikëqyrëse duhet të monitorojnë në mënyrë më intensive treguesit financiarë, sidomos zhvillimet e kredisë e të likuiditetit. Për të parandaluar pasojat e një raundi të dytë në ekonomi dhe për të mbështetur stabilitetin financiar, me rëndësi thelbësore do të jetë ngritja e kornizave të makrombikëqyrjes, falimentimit dhe rrjeteve të mbrojtjes financiare. Menaxhimi i krizave për të trajtuar në mënyrë efektive institucionet e dobëta financiare plus një kornizë për falimentimin e cila mund të zgjidhin problemet e firmave problematike do të ndihmojnë shpejt në zbutjen e mospagimeve vlerë-shkatërruese në mbarë zinxhirin e furnizimit, mund të çlirojnë stresin financiar dhe mund të sigurojnë vijimësinë e kreditimit në mbështetje të ekonomisë.

11. **Autoritetet e sektorit financiar në mbarë rajonin kanë vepruar tashmë për t'i kufizuar pasojat ekonomike dhe për të ruajtur stabilitetin financiar.** Ato po monitorojnë nga afër zhvillimet e likuiditetit dhe kreditimit, në bazë të shqetësimeve në rritje për stabilitetin financiar. Autoritetet rregullatore dhe

⁶ Shih, për më shumë informacion, "Dokumentin e politikave të Bankës Botërore për masat e lehtësimit të huamarrësve në EAQ", prill 2020; <http://pubdocs.worldbank.org/en/993701588092073659/Borrower-Relief-Measures-Note-for-ECA.pdf>.

mbikëqyrëse në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Malin e Zi dhe në Serbi kanë marrë masa të tilla si moratoriume mbi shlyerjen e kredive dhe ndryshime të klasifikimeve të riskut të kredisë (Bosnja dhe Hercegovina). Banka Kombëtare e Maqedonisë së Veriut e ka zgjatur afatin pas të cilit një kredi konsiderohet nën standard, ndërsa agjencitë mbikëqyrëse në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Malin e Zi kanë pezulluar ndarjen e dividendëve dhe dhënien e shpërblimeve.

12. **Sa i takon politikës monetare, bankat qendrore të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë i kanë ulur normat.** Serbia ka prezantuar edhe një program të mbështetjes me likuiditet për bankat nëpërmjet transaksioneve të riblerjes dhe këmbimit të normave të interesit dhe Maqedonia e Veriut i ka ndryshuar kërkesat ligjore për rezervat e denarit për kreditë e reja dhe të ristrukturuara dhe e ka shtyrë në kohë zbatimin e kërkesave ligjore për likuiditetin për t'u dhënë mundësi bankave të fokusohen te kreditimi i bizneseve dhe i familjeve. Banka e Shqipërisë e ka hequr tavanin mbi kreditë që marrin nga banka qendrore bankat e nivelit të dytë dhe ka deklaruar se nëse do të ketë kufizime të mëtejshme likuiditeti, ajo mund të përdorë lehtësim sasior, për shembull nëpërmjet blerjes së letrave me vlerë të qeverisë dhe përdorimit të rezervave brenda kufijve ligjorë. Gjithashtu, qeveritë e Shqipërisë, të Bosnjës dhe Hercegovinës, të Maqedonisë së Veriut dhe të Serbisë kanë shpallur mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për bizneset nëpërmjet dorëzanive të huave dhe kredive, të cilat do të shpërndahen nëpërmjet institucioneve financiare për zhvillim, fondeve të reja të garancive dhe sistemit bankar.

13.